

**URDHËR**  
**Nr. 306, datë 31.7.2013**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 279, DATË 14.6.2012 TË**  
**MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE**  
**NOTERIALE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 26 të ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Në aneksin 1 bashkëlidhur urdhrin nr. 279, datë 14.6.2012 të Ministrin të Drejtësisë “Për miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në listën e tarifave të shërbimeve noteriale, shfuqizohet emërtimi i shërbimit:

i) “Kontratë qiraje (të shikohet sipas afatit)” me tarifë 4.000 lekë;

ii) “Kontratë huaje, kontratë huapërdorjeje” me tarifë 4.000 lekë;

iii) “Depozitim shume” me tarifë 4.000 lekë;

iv) “Depozitim pasurie me vlerë” me tarifë 10.000 lekë; si dhe

v) “Vërtetim nënshkrimi në deklarata personale” me tarifë 1.000 lekë.

b) Në listën e tarifave të shërbimeve noteriale, ndryshohet tarifa për shërbimet e mëposhtme:

| <b>Emërtimi i shërbimit</b>     | <b>Tarifa</b> |
|---------------------------------|---------------|
| Kujtesë noteriale brenda vendit | 2.000 lekë    |
| Kujtesë noteriale jashtë vendit | 4.000 lekë    |

c) Në listën e shërbimeve noteriale, shtohen shërbimet e mëposhtme:

| <b>Emërtimi i shërbimit</b>                                   | <b>Tarifa</b> |
|---------------------------------------------------------------|---------------|
| Kontratë shkëmbimi                                            | 10.000 lekë   |
| Kontratë koncesioni                                           | 15.000 lekë   |
| Kontratë për kalimin e pronësisë pas procesit të legalizimit  | 3.000 lekë    |
| Kontrata të tjera, që nuk përfshihen në këtë listë shërbimesh | 7.000 lekë    |
| Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë testamentare               | 15.000 lekë   |
| Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore                    | 10.000 lekë   |

2. Ngarkohen të gjithë noterët për zbatimin e këtij urdhri, si dhe afishimin e tij në një ambient të dukshëm në zyrën noteriale.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë që, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë, të bëjë njoftimin e këtij urdhri dhe ndjekjen e zbatimit të tij në vijimësi.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I DREJTËSISË**  
**Eduard Halimi**